



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.2483/9prot.

Datë 04.11.2025

V E N D I M
Nr. 1596/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 04.11.2025, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr.1435/2025, datë 13.10.2025, për procedurën e prokurimit “*E hapur e Thjeshtuar*” me Nr. REF-60329-09-04-2025, me objekt “Shërbim printimi” me fond limit: 2,236,500 lekë pa TVSH, për tu zhvilluar më datë 18.09.2025, nga autoriteti kontraktor Bashkia Gjirokastrë.

Ankimues: Operatori ekonomik “IN PRINT” ShPK me NIPT L92713601Q dhe adresë: *Bulevardi Zhan D'ark, Pallati 53, Ap 6/b, Tiranë.*

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Gjirokastrë
Adresa: Rr. George Sorros, Gjirokastrë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 13.10.2025, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 1435/2025, ku vendosi:

1. *Të mbyllë çështjen mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik "IN PRINT" ShPK për procedurën e prokurimit "E hapur e Thjeshtuar" me Nr. REF-60329-09-04-2025, me objekt "Shërbim printimi" me fond limit: 2,236,500 lekë pa TVSH, për tu zhvilluar më datë 18.09.2025, nga autoriteti kontraktor Bashkia Gjirokastrë.*
2. *Autoriteti kontraktor të bëjë modifikimet me shtojcën përkatëse të dokumenteve të tenderit në SPE.*
3. *Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke publikuar shtojcën me modifikim të kriterit, sipas vendimit të KSHA-së e dokumentuar veprimet e kryera.*
4. *Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik "IN PRINT" ShPK.*
5. *Kopje e këtij vendimi t'i dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

I.2. Me shkresën ardhur me nr. 10709 prot., datë 16.10.2025, protokolluar me tonën nr. 2483/6 prot., datë 20.10.2025, autoriteti kontraktor, informon se ka zbatuar vendimin Nr. 1435/2025, datë 13.10.2025, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit sipërcituar.

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1 Me shkresën ardhur me nr. 10709 prot., datë 16.10.2025, protokolluar me tonën nr. 2483/6 prot., datë 20.10.2025, autoriteti kontraktor, informon se ka zbatuar vendimin Nr. 1435/2025, datë 13.10.2025, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit sipërcituar.

Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe verifikimeve të kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, konstatohet se, autoriteti kontraktor ka publikuar shtojcën përkatëse për modifikimin e dokumentave të tenderit të procedurës së mësipërme të prokurimit, në zbatim të vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik.

II.2. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se autoriteti kontraktor, *Bashkia Gjirokastrë* ka zbatuar vendimin Nr.1435/2025, datë 13.10.2025 të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

Përsa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenin 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur e Thjeshtuar” me Nr. REF-60329-09-04-2025, me objekt “Shërbim printimi” me fond limit: 2,236,500 lekë pa TVSH, për tu zhvilluar më datë 18.09.2025, nga autoriteti kontraktor Bashkia Gjirokastrë.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Gjergj Mersini

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiorent Zguro

